



RAPORT 6-MUJOR OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

JANAR - QERSHOR 2025

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje	3
2. Të dhëna të përgjithshme	3
2.2 Numri i procedurave të realizuara	5
2.3 Vlera e procedurave të zhvilluara	6
3. Kursimi i buxhetit	7
3.3 Procedurat e anuluar dhe arsytet përkatëse	8
4. Kërkesat për prokurim jashtë detyrimeve ligjore	9
5 Numri mesatar i ofertave.....	10
6 Të dhëna të tjera.....	12
6.1 Katalogët me specifikime teknike dhe çmime të unifikuara	12
6.2 Operatorë Ekonomikë të regjistruar	12
6.3 Forum	14
6.4 Prokurimi social.....	15
6.5 Strategjia e Zhvillimit të OBP 2025 – 2027	16

1. Hyrje

Ky raport 6-mujor paraqet një pasqyrë të detajuar të veprimtarisë së Operatorit të Blerjeve të Përqendruara për periudhën janar – qershor 2025. Raporti synon të informojë palët e interesuara mbi progresin, sfidat dhe arritjet e OBP në përmbushjen e detyrës së tij ligjore për zhvillimin e procedurave të përqendruara të prokurimit publik.

Në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 531, datë 7.9.2023, OBP ushtron funksionin e tij në shërbim të institucioneve qendrore dhe atyre të varësisë, duke synuar rritjen e efikasitetit, transparencës dhe kursimeve buxhetore përmes proceseve të unifikuara të prokurimit.


Ky dokument përmbledh të dhënat kryesore operative, analizën e performancës, sfidat e hasura dhe masat e ndërmarra për përmirësimin e vazhdueshëm të funksionimit të këtij mekanizmi qendror.

2. Të dhëna të përgjithshme

2.1 Shpërndarja e kërkesave të marra sipas institucioneve eprorë


Bazuar në VKM-në nr. 531, date 07.09.2023, OBP ofron shërbimin e prokurimit për Kryeministrinë, ministritë dhe institucionet e tyre të varësisë. Në këtë kontekst, janë analizuar kërkesat e institucioneve bazuar në varësinë e tyre nga ministritë përkatëse. Siç vërehet edhe nga grafiku i mëposhtëm, **Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale** përbën volumnin më të madh të kërkesave me **47%**. Kjo vjen për shkak të numrit të madh të spitaleve dhe strukturave të mbështetjes sociale, ku kërkesat e tyre lidhen kryesisht me blerje ushqimesh, karburanti etj. **Ministria e Brendshme** me strukturat zë vendin e dytë me **12%**, pasuar nga **Ministria e Mbrojtjes** me **11%**. Institucionet e tyre të varësisë konsistojnë në drejtori policish, reparte ushtarake etj. Institucione të tjera si **Ministria e Bujqësisë, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit** paraqiten në nivelin **6%, 6%** dhe **5%** të totalit. **Kryeministria, Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Ministria e Financave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme** kanë kërkesa më të ulëta, duke variuar nga **2%** në **4%**. Ndërkohë, **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit** paraqitet me një përqindje minimale **1%**.

Shpërndarja e kërkesave sipas institucioneve eprorë



Lidhur me burimin e të ardhurave të OBP, duke marrë në konsideratë se paraqet edhe numrin më të madh të kërkesave, **Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale** është kontribuesi më i madh, duke përfaqësuar **42.7%** të totalit të të ardhurave të realizuara nga OBP. **Ministria e Brendshme** ndjek me një peshë prej **15.7%**, institucionet e varësisë së **Ministrit të Mbrojtjes (duke përfshirë edhe vetë ministrinë)** kanë konsistuar në nivelin **13.4%** të të ardhurave të OBP. Institucione si **Kryeministria (8.1%)** dhe **Ministria e Drejtësisë (8%)** paraqesin gjithashtu nivele të rëndësishme kontributi, duke dëshmuar angazhimin e OBP në përmbushjen e nevojave të tyre të prokurimit. Ndërsa ministritë e tjera si **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (3.6%)**, **Ministria e Arsimit dhe Sporteve**, **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë**, **Ministria e Ekonomisë dhe Kulturës**, **Ministria e**

Financave dhe Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme kanë një renditje më të ulët në krijimin e të ardhurave të OBP-së, për shkak të volumit më të kufizuar të kërkesave për blerje të përqendruar.



2.2 Numri i procedurave të realizuara

Lidhur me shpërndarjen e kërkesave të paraqitura nga institucionet dhe numrin e tenderave të zhvilluar nga OBP gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2025, të klasifikuara sipas natyrës së procedurës **Punë**, **Shërbime**, dhe **Mallra**, rezultojnë si më poshtë:

- Për kategorinë **Punë**, janë paraqitur gjithsej **34 kërkesa**, për të cilat janë zhvilluar **20 tendera**.
- Për kategorinë e **Shërbimeve**, janë paraqitur **47 kërkesa**, ndërsa numri i tenderave të zhvilluar është më i lartë, **60 tendera**, çka tregon se për një pjesë të tyre janë zhvilluar procedura të ndara në lote.

- Në kategorinë **Mallra**, është regjistruar numri më i lartë i kërkesave, gjithsej **144**, ndërsa janë realizuar **77 procedura**.

Kjo shpërndarje pasqyron natyrën e punës së OBP dhe kompleksitetin e menaxhimit të kërkesave në varësi të kategorisë së prokurimit, ku veçanërisht për mallrat, evidentohen volumet më të larta dhe potenciali për optimizimin e procedurave të përbashkëta.

	Nr i kërkesave	Nr i tenderave
Punë	34	20
Shërbime	47	60
Mallra	144	77
Total	225	157

2.3 Vlera e procedurave të zhvilluara

Lidhur me analizën për të ardhurat e siguruar nga procedurat e zhvilluara, si dhe për fondin e prokuruar gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2025 ku rezulton si mëposhtë:

- Për kategorinë **Punë**, janë realizuar të ardhura në vlerën **44,979,708 lekë**, që përbëjnë **28.32%** të totalit të të ardhurave, ndërkohë që fondi total i prokuruar për këtë kategori është **2,445,031,918 lekë**, që përfaqëson **21.73%** të vlerës së përgjithshme të prokuruar.
- Për **Shërbimet**, të ardhurat e realizuara janë **46,535,469.6 lekë**, që përbëjnë **29.3%** të totalit të të ardhurave, ndërkohë që fondi i prokuruar është **2,384,599,214 lekë**, ose **21.2%** e totalit.
- Kategoria **Mallra** zë peshën më të madhe si në të ardhura ashtu edhe në fondin e prokuruar. Të ardhurat e siguruar nga procedurat për mallra kapin vlerën **67,315,606.7 lekë**, që përbëjnë **42.38%** të totalit, ndërsa fondi i prokuruar për këtë kategori është **6,420,447,831 lekë**, duke përfaqësuar **57.07%** të gjithë fondit të prokuruar.

Në total, gjatë periudhës raportuese janë siguruar të ardhura në vlerën **158,830,784.5 lekë**, ndërsa fondi i përgjithshëm i prokuruar kap vlerën **11,250,078,962 lekë**.

Nga kjo analizë evidentohet qartë se kategoria e **Mallrave** mbetet me ndikimin më të madh financiar, si në të ardhura ashtu edhe në volum të prokurimeve. Ndërkohë, procedurat për **Punë** dhe **Shërbime** ruajnë peshë të konsiderueshme në strukturën e përgjithshme, por me një ndikim disi më të ulët në fondin e prokuruar krahasuar me mallrat.

	Të ardhurat	Pesha në përqindje	Fondi i prokuruar	Pesha në përqindje
Punë	44,979,708.1	28.32%	2,445,031,918	21.73%
Shërbime	46,535,469.6	29.30%	2,384,599,214	21.20%
Mallra	67,315,606.7	42.38%	6,420,447,831	57.07%
Total	158,830,784.5		11,250,078,962	

3. Kursimi i buxhetit

Sa i përket kursimit të realizuar në raport me fondin e prokuruar, rezulton se:


- Në kategorinë **Punë**, është realizuar kursim në vlerën **215,480,968 lekë**, që konsiston në një kursim prej **14.63%** në raport me fondin e parashikuar.
- Për **Shërbimet**, kursimi i realizuar është **181,222,791 lekë**, duke arritur një përqindje të kursimit prej **17.62%**, niveli më i lartë i kursimit proporcionalisht krahasuar me kategoritë e tjera.
- Në kategorinë **Mallra**, edhe pse përbën pjesën më të madhe të fondit të prokuruar, me një vlerë totale prej **6,420,447,831 lekë (57.07% e totalit)**, kursimi i realizuar në vlerë absolute është **113,196,584 lekë**, ose **9.78%** e fondit të prokuruar për këtë kategori.

Në total, gjatë periudhës raportuese, OBP ka administruar një fond prokurimi prej **11,250,078,962 lekë**, duke arritur një kursim në vlerë absolute prej **509,900,344 lekë**, ose **11.94%** të fondit të përgjithshëm të prokuruar.

Këto tregues evidentojnë kontributin e modelit të prokurimit të përqendruar në optimizimin e kostove, me ndikim të drejtpërdrejtë në kursimet buxhetore, sidomos në kategoritë **Punë** dhe **Shërbime**, ku është arritur kursimi më i madh në përqindje.

	Fondi i prokuruar	Pesha në përqindje	Kursimi në vlerë absolute	Kursimi në përqindje
Punë	2,445,031,918	21.73%	215,480,968	14.63%
Shërbime	2,384,599,214	21.20%	181,222,791	17.62%
Mallra	6,420,447,831	57.07%	113,196,584	9.78%
Total	11,250,078,962		509,900,344	

Lidhur me krahasimin me vitet e mëparshme, evidentohet se me krijimin e OBP-së, brenda vetëm 8 muajve të parë të vitit 2024, kursimet kanë shënuar një rritje të konsiderueshme në 11.64%, duke dëshmuar efikasitetin e procesit të prokurimit të përqendruar dhe ndikimin pozitiv në përdorimin optimal të fondeve publike. Për vitin 2025, kursimet kanë arritur në nivelin më të lartë, me 14.20%, çka konfirmon konsolidimin e praktikave të prokurimit efikas dhe rritjen e transparencës dhe konkurrencës në tregun e prokurimeve publike.



3.3 Procedurat e anuluar dhe arsyet përkatëse

Lidhur me procedurat e anuluar, është analizuar periudha raportuese 6-mujore sa i përket kategorisë së prokurimit dhe arsyes së anulimit. Në total, janë anuluar **29 procedura**, të cilat ndahen si më poshtë:

- Sipas kategorisë:
 - **Shërbime:** 4 procedura të anuluar
 - **Mallra:** 25 procedura të anuluar
- Sipas arsyes së anulimit:
 - Në **20 raste**, procedurat janë anuluar për shkak se në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme.

- Në **9 raste**, anulimi ka ardhur për shkak të rrethanave të paparashikueshme, e cila lidhet me rastet e prokurimeve të uniformave të Policisë, strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes, Policisë së Burgjeve të cilat u anuluan për shkak të krijimit të Shoqërisë “Kayo” sh.a, e cila është strukturë me vetëfinancim e cila do të kryejë prodhim armatimi dhe uniformash për strukturat e sigurisë.

Nga të dhënat vihet re se pjesa dërrmuese e procedurave të anuluar lidhen me kategorinë e **mallrave**, çka tregon se ky segment mbetet më i ndjeshëm ndaj mungesës së ofertave ose problemeve në proces. Ndërkohë, anulimet në kategorinë e **shërbimeve** paraqiten në numër shumë më të kufizuar.

Numri i procedurave të anuluar	Kategoria		Arsyeja	
	Sherbime	Mallra	në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme	për shkak të rrethanave të paparashikueshme
29	4	25	20	9

4. Kërkesat për prokurim jashtë detyrimeve ligjore

Evidentohet se në 6 mujorin e parë të këtij viti, ka patur rritje të numrit të kërkesave të ardhura për objekte që nuk janë të detyrueshme për t’u prokuruar nga OBP. Afërsisht 2% e kërkesave për prokurim të trajtuara nga OBP në vitin 2024 u paraqitën vullnetarisht nga autoritetet kontraktuese. Është inkurajuese që kjo përqindje është rritur në 6% deri më tani këtë vit, duke treguar interes në rritje nga institucionet për të përdorur shërbimet e OBP në bazë vullnetare. Nga të dhënat evidentohet se janë zhvilluar procedura për një gamë të gjerë nevojash, duke përfshirë:

- **Shërbime evadimi dhe menaxhimi mbetjesh**, për spitalet publike (**Spitali Mbretëresha Geraldinë**, Spitali “Koco Gliozheni”, Qendra Spitalore “Shefqet Ndroqi”)
- **Blerje pajisjesh të sigurisë dhe emergjencave**, si setet zjarrfikëse dhe pajisjet e ndryshme për ndërhyrje të shpejtë
- **Regjistrim fillestar për 106 Zona Kadestrale etj**

Në total, për procedurat e përfshira në këtë tabelë, fondi total i prokuruar arrin në **734,867,991.34 lekë**, ndërsa tarifa pa TVSH e realizuar është **13,104,718.53 lekë**, duke konsistuar në 8% në raport me të ardhurat 6 mujore.

Institucioni	Objekti i prokurimit	Fondi limit	TARIFA PA TVSH
SPIT. OBSET. GJINEKOL. MRET. GERALDIN	Sherbimi i evadimit te mbeturinave urbane	2,004,140.00	50,103.50
DREJTORIA E PERGJ E ARKIVAVE	Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme	74,439,074.00	1,860,976.85
DREJTORIA E PËRGJTHSHME ASHK	Regjistrim fillestar për 106 Zona Kadestrale	410,679,250.00	5,000,000.00
SPIT. UNIVERS. OBSET.GJEN. KOCO GLOZHENI	Shërbim i elelminimit të mbetjeve të rrezikshme	31,689,705.00	792,242.63
DREJTORIA PERGJITHSHME BURGJEVE	Hartim i Projekt perventivit per ndertimin e kompleksit Poligon dhe palestër	2,922,840.00	73,071.00
DREJTORIA E PERGJ E ARKIVAVE	Instalim pajisje diellore	24,889,241.51	622,231.04
SPIT. OBSET. GJINEKOL. MRET. GERALDIN	Furnizim vendosje pajisje per gazra mjekesore	34,771,796.33	869,294.91
Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbr.Bimëve	Blerje vaksina kundër sëmundjes së plasjes për AKVMB-në për 2025	11,490,400.00	287,260.00
Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbr.Bimëve	Blerje e alergenëve turbekulinë bovine dhe aviare	21,694,300.00	542,357.50
QENDRA SPITALORE RAJONALE TIRANES SHEFQET NDROQI"	Evadimi i mbetjeve urbane me afat 48 muaj	13,115,362.50	327,884.06
SPIT. OBSET. GJINEKOL. MRET. GERALDIN	Evadim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme spitalore	18,300,000.00	457,500.00
DREJTORIA E PERGJ.E REZERVAVE MATERIALE TE SHTETIT	Blerje çadra strehimi rezervë shteti	52,745,214.00	1,318,630.35
Q.T.T. BUJQESORE LUSHNJE	Blerje agregate bujqësore	1,286,568.00	32,164.20
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR	Blerje set zjarrfikse , pajisje te ndryshme shpetimi	34,840,100.00	871,002.50
		734,867,991.34	13,104,718.53

5 Numri mesatar i ofertave

Pjesëmarrja mesatare e operatorëve ekonomikë mbetet një tregues kyç i transparencës, hapjes së tregut dhe efektivitetit të modelit të prokurimit të përqendruar të zbatuar nga OBP.

Tabela mëposhtë paraqet numrin mesatar të operatorëve ekonomikë që kanë marrë pjesë në procedurat e prokurimit të zhvilluara nga OBP, të ndarë sipas kategorive kryesore të prokurimeve.

Nga të dhënat rezulton se:


- Për kategorinë me pjesëmarrjen më të lartë, numri mesatar i operatorëve ekonomikë është **14.8**, çka tregon interes dhe konkurrencë të lartë në këtë segment të tregut, duke reflektuar transparencën dhe besueshmërinë e procedurave të zhvilluara nga OBP.

- Në një tjetër kategori, numri mesatar i operatorëve është **7.6**, që gjithashtu konsiderohet një tregues pozitiv i nivelit të konkurrencës dhe përfshirjes së aktorëve të tregut.
- Ndërsa në kategorinë me pjesëmarrjen më të ulët, numri mesatar i operatorëve ekonomikë është **4.9**.

	Nr . i Operatoreve Ekonomike mesatar
Punë	14.8
Shërbime	7.6
Mallra	4.9

Lidhur me krahasimin me vitet e mëparshme, nga të dhënat vërehet se pas krijimit të **Operatorit të Blerjeve të Përqendruara (OBP)**, numri mesatar i ofertave ka shënuar një përmirësim të dukshëm. Vetëm gjatë **8 muajve të parë të vitit 2024**, ky tregues ka arritur në **4.7 oferta**, ndërsa për vitin **2025** është arritur në **5.7 oferta mesatare për procedurë**, që përfaqëson nivelin më të lartë të konkurrencës së regjistruar në pesë vitet e fundit.

Kjo rritje tregon qartë ndikimin pozitiv të modelit të prokurimit të përqendruar në rritjen e transparencës, aksesit në informacion dhe përfshirjes së operatorëve ekonomikë, duke kontribuar drejtpërdrejt në krijimin e një tregu më konkurrues dhe efikas për prokurimet publike.



6 Të dhëna të tjera

6.1 Katalogët me specifikime teknike dhe çmime të unifikuara

Gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2025, janë publikuar katalogje të reja për objektet e mëposhtme:

- “Shërbime në fushën e sigurimeve” datë 20.06.2025
- “Blerje materialesh të buta dhe veshmbathje”, datë 22.04.2025

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe raportuese janë përditësuar katalogjet e mëposhtme:

- ✓ “Blerje materialesh të ndryshme për pastrim” datë 17.06.2025
- ✓ “Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim”, datë 07.05.2025
- ✓ “Blerje artikujsh ushqimorë”, i përditësuar, datë 14.02.2025

6.2 Operatorë Ekonomikë të regjistruar

Në funksion të transparencës dhe lehtësimit të aksesit në informacion, Operatorët Ekonomikë kanë mundësinë të regjistrohen në platformën zyrtare të OBP-së, www.obp.al. Ky proces u mundëson atyre të informohen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të shpejtë për çdo procedurë të re prokurimi të publikuar nga OBP.

Pasi kryejnë regjistrimin në platformë, operatorët ekonomikë marrin automatikisht njoftime në adresën e tyre elektronike sa herë që publikohen procedura të reja tenderimi, në përputhje me kategoritë dhe fushat e interesit që ata kanë përcaktuar gjatë regjistrimit.

Ky mekanizëm rrit ndjeshëm transparencën, mundëson pjesëmarrje më të gjerë në procedurat e prokurimit dhe redukton mundësinë që operatorët të humbasin informacionin mbi mundësitë e ofruara nga OBP.

Deri më sot, në platformën **OBP.al** janë regjistruar gjithsej **509 operatorë ekonomikë**, duke krijuar një bazë të qëndrueshme të tregut dhe duke lehtësuar qarkullimin e informacionit në mënyrë të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit potencialë.

Ky numër pritet të rritet më tej, si rezultat i vazhdimit të fushatave informuese dhe angazhimit për përmirësimin e aksesit të operatorëve ekonomikë në proceset e prokurimit të përqendruar.

Të ndara sipas objekteve të prokurimit, ndahen si mëposhtë:

Objekti i prokurimit	Nr. OE
tjetër	225
rikonstruksion objektesh	154
Ndërtime	126
Blerje materialesh elektrike, hidraulike dhe ndërtimi	124
Mirëmbajtje e sistemeve/impianteve elektrike, hidraulike	123
Supervizime dhe kolaudime të punimeve që i përkasin procedurave të prok., objekt të vep. së OBP	94
shërbim lyerjeje dhe mirëmbajtjeje të ndërtesave publike	92
blerje pajisjesh kondicionimi	92
blerje materialesh kancelarie	90
Blerje kamerash/sistemesh vëzhgimi dhe alarmi	88
riparim e mirëmbajtje sistemesh të ngrohje-ftohjeve	86
blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim	84
Blerje automj., autovet., ambulancash, mjetesh rrug. që përdoren për transp njerëzish, mjetesh rrugo	81
blerje materialesh të ndryshme për pastrim	72
blerje uniformash dhe elementesh të tjera përbërëse të tyre	70
shërbim gjelbërimi	63
blerje tonerash	62
blerje paj. lab., si dhe mjetesh didaktike, të lidhura me proc. e punës, me përjashtim të atyre mjek	62
blerje pjesësh këmbimi për automjete, për shërbimet profilaktike	57
botime, printime dhe materiale shtypshkrimi	55
riparim dhe mirëmbajtje automjetesh	54
blerje materialesh të buta dhe veshmbathjesh	54
blerje këpucësh	47
Të gjitha	46
Blerje pajisjesh/pjesësh për burimin, ushqimin dhe energjinë (BUE)	44
blerje artikujsh ushqimorë	43
shërbim pastrimi	42
shërbime dezinfektimi, deratizimi dhe dezinfektimi	38
Përzgjedhja e subj. private me eksp. ndërkomb. si ofrues shërbimi në fushën e prok., sipas LPP	36
Blerje dhe/ose mirëmbajtje ashensorësh	32
Qira operationale automjetesh	31
shërbim lavanderie	30

shërbim gatimi dhe shpërndarjeje ushqimi	27
sigurim i automjeteve	18
sigurim i godinave publike	18
blerja karburanti, me përjashtim të vajgurit Jet A1 dhe karburantit që prok për përdorim nga fermerë	16
sigurim jete dhe shëndeti	16
sigurim i mjeteve lundruese	13
sigurim i mjeteve ajrore	13

6.3 Forum

Në kuadër të rritjes së komunikimit me operatorët ekonomikë, institucionet dhe të interesuarit, në platformën zyrtare **OBP.al** është shtuar një kategori e re e dedikuar: **FORUM**.

Ky seksion i dedikohet pyetjeve dhe përgjigjeve mbi çdo aspekt që lidhet me prokurimet e përqendruara. Çdo vizitor i faqes ka mundësinë të shkruajë pyetje, qartësime apo paqartësi që lidhen me procedurat e prokurimit, dokumentacionin, mënyrën e pjesëmarrjes, kriteret teknike apo çdo çështje tjetër që ka lidhje me veprimtarinë e OBP.

Përgjigjet në këtë forum jepen nga stafi i specializuar dhe ekspertët e OBP-së, duke garantuar informacion zyrtar, të saktë dhe të aksesueshëm për të gjithë.

Forumi është një hapësirë publike, e hapur për të gjithë, ku transparenca, sqarimi i praktikave dhe qasja e barabartë në informacion janë në qendër të vëmendjes.

Ftojme të gjithë operatorët ekonomikë, institucionet dhe palët e interesuara të shfrytëzojnë këtë mundësi për të adresuar pyetjet e tyre dhe për të marrë përgjigje të qarta dhe të besueshme, drejtpërdrejt nga ekspertët e fushës.

FORUM

Emri *

Drejto pyetjen: *

DËRGO

6.4 Prokurimi social

Në kuadër të angazhimit për promovimin e punësimit dhe përfshirjes sociale, Operatori i Blerjeve të Përqendruara ka integruar në procedurat e prokurimit elementët e Prokurimit Social, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Prokurimi Social konsiston në vendosjen e kriterëve sociale në dokumentet e tenderimit, duke krijuar mundësi konkrete punësimi për kategori vulnerabël të shoqërisë, në veçanti për personat e papunë, të regjistruar pranë institucioneve shtetërore të punësimit.

Në zbatim të këtij angazhimi, është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorit të Blerjeve të Përqendruara (OBP) dhe Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA), e cila synon rekrutimin e personave të papunë përmes projekteve të prokuruar nga OBP.

Si rezultat konkret i këtij bashkëpunimi, gjatë periudhës raportuese janë rekrutuar 50 punëkërkues të papunë, të cilët janë përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbatimin e projekteve të financuara përmes procedurave të zhvilluara nga OBP.

Ky është një hap i rëndësishëm drejt krijimit të mundësive të reja të punësimit, forcimit të dimensionit social të prokurimeve publike dhe mbështetjes aktive të integritetit në tregun e punës për individët në nevojë.



PROKURIMI ME PËRGJEGJËSI SOCIALE

50

persona të regjistruar si të papunë
janë rekrutuar në projektet e prokuruar
nga OBP në periudhën shkurt-qershor 2025



6.5 Strategjia e Zhvillimit të OBP 2025 – 2027



Gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2025, është konceptuar një dokument i rëndësishëm për mbarrëvajtjen e punës: Strategjia e Zhvillimit të OBP 2025 – 2027. Dokumenti i Planit Strategjik të Zhvillimit nga OBP paraqet vizionin e OBP në përputhje me vizionin zhvillimit të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Qeverisë Shqiptare.

Qëllimi i këtij dokumenti është hartimi i një platforme strategjike e cila jep bazat për një zhvillim të qëndrueshëm për të gjithë strukturat e OBP duke siguruar një zhvillim sa më të balancuar ekonomik dhe social. Kjo strategji synon të përmbushë nevojën për të harmonizuar të gjitha veprimtaritë e OBP në fushën e prokurimeve të

përqendruara në një vizion të përbashkët dhe koherent me MEKI dhe qeverinë Shqiptare të fokusuar në disa fusha prioritare.

Si e tillë synon:

- ✓ Përmirësimin në vazhdimësi të veprimtarisë.
- ✓ Identifikimin e veprimtarive kryesore dhe planifikimin mjeteve të nevojshme.
- ✓ Të ndihmojë bashkëpunimin me të gjithë aktorët relevant për përmbushjen e objektivave për OBP.

Bazuar në këtë dokument zhvillohen planet operuese për secilin vit, ku përcaktohen objektivat vjetore prioritare, aktivitetet konkrete dhe mjetet/burimet përkatëse.